



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.1427/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen përmbarimore të kreditorit Teb Sh.A. me seli në Prishtinë, kundër debitorëve: 1. Roll Matik LLC me numër të biznesit 71145611, rr. ..., nr.9, Prishtinë, e përfaqësuar nga B.S. me numër personal ... dhe V.M. me numër personal ... (kredimarrësit), 2. N.SH.T. Elektro Monto Roll, me numër të biznesit 70654466, rr. Januz Zejnullahu, nr.9, Prishtinë, përfaqësuar nga V.M. me numër personal ... (Bashkekredimarrësi), 3. B.S., rr. ..., Prishtinë, me numër personal ... (Bashkë-kredimarrësi), 4. V.M., rr. ..., Prishtinë me numër personal ... (Bashkë-kredimarrësi), për shkak të borxhit, në bazë të marrëveshjes mbi pengun, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.1107/22, të datës 31.08.2023, më datën 01.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e kreditorit Teb Sh.A., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.1107/22, të datës 31.08.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.1107/22, të datës 31.08.2023, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar si të bazuar prapësimi i debitorit N.SH.T. Elektro Monto Roll, me numër të biznesit 70654466, anulohet urdhri përmbarimor P.nr. 1197/21, i datës 27.08.2021, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Isa Gacaferi dhe përfundohet në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore, në pikën II të dispozitivit ka detyruar kreditori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e prapësimit t'ia paguaj debitorit shumën prej 156.00 € (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë euro) në afat prej 7 (shtate) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Kundër aktvendimit të lartcekur brenda afatit ligjor ka ushtruar debitori për shkak të: të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, shkeljes së dispozitave, vërtetimi të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkallës së dytë të aprovoj si të bazuar ankesën kreditorit, dhe ta prishë aktvendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.1107/22, të datës 31.08.2023, si dhe ta shfuqizojë urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr. 1197/21, i datës 27.08.2021.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori Teb Sh.A., ka paraqitur propozim për përbarim ndaj debitorëve 1. Roll Matik LLC me numër te biznesit 71145611, rr. ..., nr.9, Prishtinë, e përfaqësuar nga B.S. me numër personal ... dhe V.M. me numër personal ... (kredimarrësit), 2. N.SH.T. Elektro Monto Roll, me numër te biznesit 70654466, rr. Januz Zejnullahu, nr.9, Prishtine, përfaqësuar nga V.M. me numër personal ... (Bashkekredimarrësi), 3. B.S., rr. ..., Prishtine, me numër personal ... (Bashkë-kredimarrësi), 4. V.M., rr. ..., Prishtine me numër personal ... (Bashke-kredimarrësi), në bazë të mbi bazën e dokumentit: Marrëveshje mbi Kredinë nr. 68255 e datës 12.06.2018 dhe Shtojca 1) Marrëveshja mbi Pengun, Marrëveshja mbi Mbitërheqjen nr. 74594 e nënshkruar me date 25.06.2019 si dhe shtoja 1) Marrëveshja mbi Pengun, Marrëveshja per Mbitërheqjen nr. 80072 e nënshkruar me date 15.07.2020, si dhe Shtoja 1) Marrëveshja mbi Pengun, Lista e Pengut nr.68255 ne vlere prej 26,169.14 €, lista e pengut nr. 74594 ne vlere prej 39,594.00 € te datës 21.06.2019, Lista e Pengut nr. 80072 ne vlere prej 45,972.00 € te datës 14.07.2020, Konfirmimi i regjistrimit të pengut ne Zyrën e Regjistrimit te Pengut - MTI nr. R-20180618 i datës 18.06.2018-13.08.2021, duke propozuar që Përmbaruesi Privat të nxjerrë Urdhër Përmbarimor me të cilin lejohet përbarimi për pagesën e borxhit të përgjithshëm prej 16,058.03, deri në përmbushjen definitive të detyrimit të debitorëve ndaj kreditorit.

Përmbaruesi Privat Isa Gacaferi me seli në Prishtinë, me Urdhrin Përmbarimor P.nr. 1197/21, i datës 27.08.2021, ka caktuar përbarimin, duke vlerësuar se dokumentet përbarimore të lartcekura, i plotësojnë kushtet për përbarim.

Ndaj këtij urdhri ka paraqitur prapësim debitori, duke propozuar që të anulohet urdhri për përbarim P.nr. 1197/21, i datës 27.08.2021, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Isa Gacaferi, dhe të abrogohen të gjitha veprimet përbarimore të ndërmarra lidhur me propozimin për përbarim të dt. 15.09.2021.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditorit, duke i cilësuar pretendimet e debitorit si të pa bazuara dhe përpjekje për zvarritjen e procedurës së përbarimit, me propozim që Gjykata Komerciale te Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë, prapësimin e debitorit të pa bazuar dhe të pa argumentuar ligjërisht, dhe të konfirmoj-vërtetoj urdhrin përbarimor P.nr. 1197/21, i datës 27.08.2021 nga Përmbaruesi Privat Isa Gacaferi me të cilin është lejuar përbarimi për kredinë e debitorëve të lartshënuar.

Gjykata Komerciale te Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë, me aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.1107/22, të datës 31.08.2023, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar si të bazuar prapësimi i debitorit N.SH.T. Elektro Monto Roll, me numër të biznesit 70654466, anulohet urdhri përbarimor P.nr. 1197/21, i datës 27.08.2021, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Isa Gacaferi dhe përfundohet në tërësi përbarimi në këtë çështje përbarimore, në pikën II të dispozitivit ka detyruar kreditori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e prapësimit t'ia paguaj debitorit shumën prej 156.00 € (njëqind e pesëdhjetë e gjashte euro) ne afat prej 7 (shtate) ditësh, pas plotfuqishmërisë se këtij aktvendimi, duke vendosur si në dispozitiv të të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar Gjykatës Komerciale te Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë, ka theksuar se gjykata ka vlerësuar dokumentet përmbaruese si : Marrëveshje mbi Kredinë nr. 68255 e datës 12.06.2018 dhe Shtojca 1) Marrëveshja mbi Pengun,

Marrëveshja mbi Mbitërheqjen nr. 74594 e nënshkruar me date 25.06.2019 si dhe shtoja 1) Marrëveshja mbi Pengun, Marrëveshja për Mbitërheqjen nr. 80072 e nënshkruar me date 15.07.2020, si dhe Shtoja 1) Marrëveshja mbi Pengun, Lista e Pengut nr.68255 ne vlere prej 26,169.14 €, lista e pengut nr. 74594 ne vlere prej 39,594.00 € të datës 21.06.2019, Lista e Pengut nr. 80072 ne vlere prej 45,972.00 € të datës 14.07.2020, Konfirmimi i regjistrimit të pengut në Zyrën e Regjistrimit te Pengut - MTI nr. R-20180618 i datës 18.06.2018-13.08.2021, në bazë të të cilave përmbaruesi privat ka zbatuar përmbarimin, e të cilat dokumente përmbaruese përbëjnë bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase i kanë plotësuar kushtet ligjore nga neni 21, 22 dhe neni 27, për të qenë të përmbarueshëm dhe njëkohësisht të përshtatshme për përmbarim. Po ashtu, ka theksuar se gjykata ka shikimin e shkresave të lëndës, ka analizuar pretendimet e debitorëve në prapësim dhe ka vlerësuar se janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara në ligj, për arsye se nuk kanë ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tyre siç është paraparë me nenin 69 par.4 të LPP-së, dhe erdhi në përfundim se nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e Urdhrit të Përmbaruesit Privat, të përcaktuara me dispozitat e nenit 71, par.1, pika 1 deri në 12 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (Ligji nr.04/L-139), të Republikës së Kosovës. Prandaj, nga arsyet e paraqitura, në bazë të nenit 73 të LPP-së, kjo gjykatë gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe të njëjtin e refuzoj, si në dispozitiv të aktvendimit.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm vlerësimin dhe qëndrimin juridik të Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkëlqje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Kreditori Teb Sh.A., në ankesën e ushtruar ka theksuar gjykata me rastin e marrjes së aktvendimit të ankimuar ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale, shkëlqeve të dispozitave procedurale dhe vlerësimin të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike, gjegjësisht dispozitave të LPP-së, për shkak se nuk ka vlerësuar drejtë dhe nuk i ka marrë parasysh fare pretendimet e kreditori të parashtruara me ankesë dhe urdhërin përmbarimor. Po ashtu, ka theksuar se arsyet e përmendura në ankesë sa i përket nenin 10.1 të LPK-së, gjykata ka për detyrë të përpiqet që procedurën të zhvilloj pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzimet, si dhe të bëjë pamundur cdo shpërdorim të së drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji, gjithashtu me procedura përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtës juridike të konstatuara në dokumentin përmbarimor, i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatojë përmbarimin.

Gjykata Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë pretendimet ankimore te debitorit i vlerëson si të bazuara dhe të pa qëndrueshme, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se prapësimi nuk është i bazuar dhe nuk përmban asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e Urdhri të Përmbaruesit Privat, të përcaktuara me nenin 71 të LPP-së. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate Marrëveshje mbi Kredinë nr. 68255 e datës 12.06.2018 dhe Shtojca 1) Marrëveshja mbi Pengun, Marrëveshja mbi Mbitërheqjen nr. 74594 e nënshkruar me date 25.06.2019 si dhe shtoja 1) Marrëveshja mbi Pengun, Marrëveshja për Mbitërheqjen nr. 80072 e nënshkruar me date 15.07.2020, si dhe Shtoja 1) Marrëveshja mbi Pengun, Lista e Pengut nr.68255 në vlere prej 26,169.14 €, lista e pengut nr. 74594 në vlere prej 39,594.00 € të datës 21.06.2019, Lista e Pengut nr. 80072 në vlere prej 45,972.00 € te datës 14.07.2020, Konfirmimi i regjistrimit të pengut në Zyrën e Regjistrimit të Pengut - MTI nr. R-20180618 i datës

18.06.2018-13.08.2021, nuk paraqet dokument përmbarese (*titulus executionis*) në kuptim të dispozitave të nenit 22 par.1 pika 1.7 të Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbare, lidhur me nenin 5 par.2 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbare. Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se marrëveshja mbi pengun Nr.68255 e datës 12.06.2018, nuk ka efekt për shkak të kalimit të afatit të regjistrimit, ndërsa marrëveshjet e pengut Nr.74594 të datës 25.06.2019 si dhe Marrëveshja e pengut e datës Nr.74594 e datës 15.07.2020, në mungese të dëshmime në shkresa të lëndës, nuk mund të vërtetohet se janë regjistruar në regjistrin e pengut. Gjykata sqaron se kohëzgjatja e pengut të regjistruar, ndryshimi i regjistrimit të pengut dhe shuarja e të njëjtit janë rregulluar me Ligjin nr.04/1-136 për regjistrimin e pengut në regjister për sendet e luajtshme, ashtu që me nenin 23 përcaktohet se: "*Një regjistrim është i vlefshëm varësisht prej zgjedhjes së pronarit të llogarisë së përdoruesit përmes përdorimit të SRP-se*", ndryshimi i regjistrimit rregullohet me nenin 24 me të cilin përcaktohet se "*Regjistrimi mund të ndryshohet nga pronari i llogarisë së përdoruesit nga i cili është bërë regjistrimi. 2. Duke përdorur SRP-në, mund të bëhen ndryshimet e mëposhtme në regjistrime: 2.1. vazhdimi i regjistrimit; 2.2. shlyerja e regjistrimit; 2.3. shlyerja e pengmarrësit; 2.4. shlyerja e pengdhënësit, 2.5. shlyerja e mallrave me numër serik; 2.6. ndryshimi i sendeve tjera të luajtshme; 2.7. shtimi i pengmarrësit; 2.8. shtimi i pengdhënësit dhe 2.9. shtimi i mallrave me numër serik.*", ndërsa me nenin 27 përcaktohet se: "*Regjistrimi përfundon automatikisht nga SRP me përfundimin e periudhës së regjistrimit*". Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumentet, kontratat për pengun, të lidhura në mes të kreditorit dhe debitorëve, në baze të cilave edhe është lejuar përmbare, nuk i përmbushin kushtet ligjore nga neni 22 të LPP-se, konkretisht neni 5 par.2 pika 1.7a të Ligji Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/1-139 për Procedurën Përmbare, ngase nuk i kanë plotësuar kushtet ligjore nga neni 27 i LPP-se, kjo për shkak të kalimit të afatit të regjistrimit të pengut sipas marrëveshjes nr.68255, respektivisht shuarjes së pengut konform dispozitave të lartëcekura, e që sipas shkresave të lëndës vërtetohet se përfundimi i periudhës së regjistrimit të pengut është një muaj më herët se parashtrimi i propozimit për përmbare, dhe se në shkresat të lëndës nuk ka ndonjë informacion i cili do të vërtetonte se regjistrimi i pengut është vazhduar nga kreditori. Po ashtu, në mungese të konfirmimit të regjistrimit të pengut sipas kontratave Nr. 74594 të datës 25.06.2019 dhe Marrëveshja e pengut e datës Nr.74594 e datës 15.07.2020, këto marrëveshje nuk janë të përshtatshme për përmbare.

Me nenin 22 par.1 pika 1.7 të Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbare përcaktohet se "*1. Dokumente përmbare janë: 1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit*". Ndërsa me dispozitën ligjore nga neni 5 par.2 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbare, përcaktohet se "*Neni 22 i ligjit bazik, paragrafi 1., pas nën-paragrafit 1.7., shtohet nën-paragraf i ri 1.7a. me tekstin si në vijim. 1.7a. kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut*".

Duke u mbështetur në nenin 69 par.4 të LPP "*baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet*", me çka debitori nuk ka ofruar ndonjë provë për të vërtetuar të kundërtën e kreditorit, por edhe pretendimet e vetë debitorit në prapësim. Prandaj, sipas vlerësimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, pretendimet ankimore të kreditorit nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ngase me nenin 21 të Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbare përcaktohet se "*Organi përmbare e cakton, përkatësisht e zbaton përmbaremin vetëm në bazë të dokumentit përmbare dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*". Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo

arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur t'i shkaktohet apo mund t'i shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes së përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbarimit në këtë rast.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore. Andaj, me të drejtë gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit të parashtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr. 1197/21, i datës 27.08.2021.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e shkallës së dytë

Kom.Dh.Shk.II.nr.1427/23 dt.01.03.2024

**Gjyqtari,
Faton Bajrami**